C.nr.1005/09

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë civile e shkallës së parë, nga gjyqtari Naim Kurtishi, me sekretaren juridike Drita Gërmizaj, në çështjen juridike të paditësve – kundër të padituve: A. A., A1. A., K. B. dhe M. S. të gjithë nga Prizreni, të cilët i përfaqëson av. F. J. nga Prizreni, kundër të padituit – kundërpaditësit R. K. nga Prizreni të cilin e përfaqëson H. K. av. nga Prizreni, për shkak të dorëzimit të patundshmërisë dhe vërtetimit të pronësisë, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor publik me dt.29.05.2013 në prezencën e palëve – të autorizuarve të tyre morri këtë:

A K T GJ Y K I M

I. **APROVOHET në TËRËSI** si **e bazuar** kërkesëpadia e paditësve – kundër të padituërve A. A., A1. A., K. B. dhe M. S. të gjithë nga Prizreni, dhe se i padituri – **kundërpaditësi R. K. nga Prizreni OBLIGOHET** që paditësve t'ua kthejë – dorëzoj në posedim dhe shfrytëzim të lirë patundshmërinë me shënime parc.kad.nr.6856/1 në vendin e quajtur "B." e që është në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.77.90 ha, e që evidentohet në list.posed.nr.11704 ZK Prizren, njëherit i padituri nga kjo ngastër kadastrale duhet t'i heq të gjitha shtyllat dhe telat e metalit të vendosura në këto shtylla dhe paditësve t'u dorëzoj këtë sipërfaqe në shfrytëzim të lirë dhe të pa penguar, dhe atë brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

II. **REFUZOHET si e PA BAZUAR** kërkesa nga kundërpadia e të padituit – kundërpaditësit R. K. nga Prizreni me të cilën ka kërkuar që:

- **të vërtetohet se i padituri – kundërpaditësi R. K. nga Prizreni** në bazë të shitblerjes dhe në bazë të mbajtjes është pronar i parc.kad.nr.6856/1 në vendin e quajtur "B.", në sipërfaqe prej 0,77.90 ha, e që evidentohet sipas flet.posed.nr.11704 ZK Prizren, **gjë që detyrohen kundër të padituit – paditësit A. A., A1. A., K. A. dhe M. A. të gjithë nga Prizreni** që të pranojnë këtë të drejtë dhe kundër të padituit – paditësit R. K. t'i lejoj që kjo patundshmëri të regjistrohet në regjistrin e paluajtshmërive në emër të tij – R. K. nga Prizreni, të gjitha këto brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me kërcënim ekzekutimi.

III. **MBETET në FUQI MASA E SIGURIMIT** e dhënë me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.1005/09 të dt.04.10.2010.

IV. **OBLIGOHET** i padituri – kundër paditësi R. K. që paditësve t'ua kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë në shumë prej 885 Euro të cilat duhet t'u paguaj brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit në të dhënat e cekura në padinë e shkruar, të dhënat e cekura gjatë shqyrtimeve të mbajtura si dhe i autorizuari i tij av. F. J. po ashtu gjatë shqyrtimeve të mbajtura në vazhdimësi si dhe në të dhënat e cekura gojarisht në shqyrtimin përfundimtar të dt.29.05.2013 dhe të dhënat e cekura në fjalën e fundit të dhënë me shkrim kërkojnë që gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave që janë administruar në këtë çështje, si dhe faktet që janë vërtetuar, e njëjta pra gjykata në tërësi të aprovoi kërkesë padinë e paditësve me të cilën kërkojnë që i padituri të obligohet që patundshmërinë dhe atë me shënime parc.kad.nr.6856/1 në vendin e quajtur "B." e që është në sipërfaqe prej 0.77,90 ha dhe e evidentuar në list.posed.nr.11704 ZK Prizren t'ia dorëzoj në shfrytëzim të lirë dhe të pa penguar paditësve, me që është kërkesë kjo plotësisht e bazuar. Po ashtu i autorizuari i paditësve gjatë shqyrtimeve të mbajtura gjykatës i ka propozuar refuzimin e tërësishëm të kundër kërkesëpadisë së të paditurit – paditësit R. K. kur i njëjti kërkon që të vërtetohet se është pronar i kësaj ngast.kad.me shënime të lart cekura, kështu që këtë kërkesëpadi i autorizuari i paditësve e arsyeton me sa vijon:

Vërtetë nga provat që janë administruar nuk është kontestues fakti se kjo patundshmëri kontestuese nga shiqimi i list.posed.nr.12 i dt.05.11.1950 ka qenë pronë e regjistruar në emër të pronarit të saj H. A. – të atit të paditësve. Po ashtu sqarojnë se kjo patundshmëri më vonë në vitin 1963 në bazë të kontratës mbi shitblerjes asaj Vr.nr.1850/63 të dt.08.11.1963 pa vullnetin e kontraktuesit – shitësit H. A. e njëjta patundshmëri i merret dhe kalon në pronarin e ri – PIK "Progres-export" nga Prizreni. Më vonë paditësit nuk heqin dorë në pretendimet e kthimit të kësaj patundshmërie që i është marrur të atit të tyre, gjatë viteve 1984 të njëjtën patundshmëri e kanë marrur në shfrytëzim me qesim nga PIK "Progres". Po ashtu sqarojnë për faktin se paditësit si trashëgimtarë të vetëm ligjor të të ndjerit H. A. iniciojnë procedurë gjyqësore në Gjykatën Komunale të Prizrenit dhe me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate atë **C.nr.1058/94 të dt.07.12.l995** të njëjtit fitojnë kontestin gjyqësorë, pra fitojnë të drejtën e pronësisë dhe të posedimit në patundshmërinë atë parc.kad.nr.6856 arë e klasit të III në vendin e quajtur "B." në sipërfaqe të përgjithshme prej 1.23.90 ha e regjistruar në list.posed.nr.8417 ZK Prizren. Me aktgjykimin e **Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.167/96 të dt.24.04**.1996 vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren kështu që paditësit bëhen pronarë të ligjshëm të kësaj patundshmërie dhe se **me vendimin e shërbimit kadastral në Prizren – me nr.952-01-174/96 të dt.21.06.1996** bëhet – regjistrimi i kësaj patundshmërie në emër të bashkëpronarëve – tani paditësve me pjesë të barabarta me nga **¼.**

Pra nga këto prova materiale – aktgjykimet e plotfuqishme dhe vendimit të shërbimit kadastral patundshmëria në fjalë ajo parc.kad.nr.6856 në vendin e quajtur "B." në sipërfaqe të përgjithshme prej 1.23.90 ha evidentohet në emër të bashkëpronarëve – tani paditësve A. A. etj. e regjistruar në list. posed. nr. të vjetër 8417. Po ashtu i autorizuari i paditësve sqaron për faktet se gjatë vitit 2000 pa kurrfarë dijenije të paditësve dhe në dëm të tyre bëhet ndryshimi i kësaj patundshmërie me shënime të lartpërmendura pra të ngast.kad.nr.6856 e cila ngastër copëtohet nga ky shërbim kadastral dhe sipërfaqja prej 0.77.90 ari – të ngastrës 6856/1 që evidentohet në list.posed.nr.11704 ZK Prizren evidentohet në emër të paditësve me pjesë prej ¼ për secilin, ndërsa pjesa tjetër e copëtuar nga tërësia e kësaj ngastre ajo në sipërfaqe prej 43 ari regjistrohet

në emër të pronarit të ri R. Zh. dhe se paditësit tani me këtë kërkesëpadi kërkojnë vetëm dorëzimin e patundshmërisë atë me shënime si në padi e të cilën pa të drejtë e mban i padituri – kundërpaditësi R. K., pra sipërfaqen prej 0.77,90 ari të ngastrës 6856/1 list.posed.nr.11704 ZK Prizren ndërsa për pjesën e copëtuar atë në sipërfaqe prej 43 ari paditësi ka iniciuar procedurë të veçantë dhe ajo pjesë nuk është objekt kontesti i kësaj kërkesëpadie.

Po ashtu i autorizuari i paditësve sqaron për faktin se nuk është kontestues fakti kur i padituri – kundërpaditësi R. K. gjatë kohës kur kjo patundshmëri kontestuese ka qenë e regjistruar në emër të PIK "Progresit" i njëjti ka lidhur kontratë me "Progresin" dhe këtë patundshmëri e ka marrur me qesim. Mirëpo nga viti 1996 kur paditësit fitojnë të drejtën e pronësisë në këtë patundshmëri, vetë i padituri R. K. ka ardhur në shtëpinë e paditësve nga të cilët ka kërkuar që tani të njëjtët si pronarë të ri, atij t'i japin me qesim këtë patundshmëri – këtë ngastër kadastrale në fjalë, dhe se paditësit nuk kanë kontestuar këtë propozim pra i kanë dhënë në shfrytëzim me qesim për shumën simbolike prej 100 DM. Po ashtu sqaron për faktin se gjerë në vitet 2005 të njëjtit nuk kanë pasur mosmarrëveshje, por kur paditësit kanë hyrë në posedim të kësaj ngastre që është pronë e tyre, është ky moment kur prishen raportet e tyre dhe i padituri – kundërpaditësi R. K. refuzon dorëzimin e kësaj patundshmërie pronarëve të tyre tani paditsëve. Pra nga këto sjellje të padituri, paditësit si pronarë legjitim të kësaj patundshmërie kërkojnë mbrojtje ligjore me padinë e paraqitur në këtë gjykatë duke kërkuar aprovimin e saj si të bazuar, nga fakti se pala e paditur gjatë shqyrtimeve të mbajtura ka shpreh dëshirë për të dhënë një shumë të hollash prej 40-50 mijë Euro në mënyrë që të zgjidhet çështja e kësaj patundshmërie por paditësit mendojnë se është shumë simbolike nga vlera reale e kësaj patundshmërie, dhe se janë të gjitha këto arsyera reale dhe ligjore për aprovimin e kërkesëpadisë të paditësve.

I autorizuari i paditësve në vazhdim është deklaruar edhe lidhur me kundër kërkesëpadinë e të padituri – paditësit R. K. në rrethanat se kjo kërkesëpadi e kësaj pale është kërkesëpadi e pa bazuar nga se i njëjti me asnjë provë materiale apo jo materiale nuk ka mundur të argumentojnë faktin se këtë patundshmëri e ka blerë nga ish pronari – i ndjeri H. A. dhe se në këtë drejtim nuk ka ofruar kurrfarë kontrate, ndërsa kur është fjala për pretendimet e të padituri – kundërpaditësit R. K. se ai në vazhdimësi e ka shfrytëzuar me qesim këtë patundshmëri, nuk janë këto fakte të ligjshme dhe të bazuara në bazë të të cilave mund të fitohet pronësia, pra janë këto arsyera në bazë të të cilave gjykata duhet ta refuzoi në tërësi kundër kërkesëpadinë e të padituri – kundërpaditësit R. K. Përndryshe i autorizuari i paditësve është deklaruar se kërkon kompensimin e të gjitha shpenzimeve të kësaj procedure në shumë prej 885 Euro të llogaritura në bazë të AT-së të aplikueshme.

Duke u përgjigjur në të dhënat e kësaj kërkesëpadie, i autorizuari i të padituri – kundërpaditësit – av. H. K. gjatë shqyrtimeve të mbajtura si dhe në të dhënat e dhëna në përgjigjen me shkrim në këtë padi të paditësit dhe të dhënat e cekura në kundërpadinë e të padituri – paditësit R. K., propozon që padia e paditësve në tërësi të refuzohet si kërkesë e pa bazë, me të cilën paditësit pa të drejtë kërkojnë kthimin në posedim të ngast.kad.nr.6856/1 që evidentohet në list.posed.nr.11704 ZK Prizren e që është në sipërfaqe prej 0.77,90 ha, nga se i padituri – kundërpaditësit R. K. është pronar legjitim i kësaj patundshmërie dhe atë nga këto arsyera:

I padituri – kundërpaditësi R. K. këtë patundshmëri në fjalë e ka blerë nga ish pronari i saj tani i ndjeri H. A. – i ati i paditësve dhe atë qysh në vitin 1958 duke paguar çmimin prej 5000 Qese, të cilin fakt e kanë vërtetuar edhe dëshmitarët e dëgjuar në këtë çështje juridike, pra në bazë të kësaj shitblerje i padituri R. K. ka fituar të drejtën e pronësisë, mirëpo për shkak të zjarrit që ka dëmtuar shtëpitë e tija i njëjti nuk ka mundur të siguroj kontratën e shkruar në mes të këtyre palëve kontraktuese. Po ashtu sqaron për faktin se i padituri – kundërpaditësi R. K. vite të tëra pra që nga viti 1958 e në vazhdimësi gjerë në vitin 1996 këtë patundshmëri e ka shfrytëzuar në bazë të kontratës me qesim të lidhur me PIK "Progresin", e duke i paguar edhe anuitetet tjera rreth shfrytëzimit të ujit për këtë patundshmëri. Pra janë këto fakte dhe arsyera ligjore që argumentojnë arsyeshmërinë e kësaj kundërkërkesë padie se i padituri – kundërpaditësi R. K. ka fituar të drejtën e pronësisë në këtë patundshmëri edhe në bazë të mbajtjes – parashkrimit fitues nga se shfrytëzon të njëjtën patundshmëri më shumë se 40 vite, e duke vazhduar edhe sot e kësaj dite. Janë këto arsyera ligjore në bazë të të cilave propozojnë aprovimin e kësaj kundër kërkesëpadie, duke kërkuar edhe kompensimin e shpenzimeve të kësaj procedure në shumë prej 900 Euro.

Në këtë çështje juridike gjykata bëri administrimin e këtyre provave:

Shiqimin e listës poseduese me nr.11704, leximin e vërtetimit nr.423 lëshuar nga KRU "Radoniqi" – Dukagjini Gjakovë, leximi i kontratave nr.72 i dt.30.12.1974, nr.29 vitit 1975, nr.55 dt.20.02.1978, nr.265 i dt.10.12.l979, nr.19 të dt.21.08.1981, nr.58 i dt.09.12.1985, është bërë leximi i marrëveshjes së shkruar mbi shitblerjen e patundshmërisë për ngastrën kad.nr.6856/1 e dt.03.06.2005, bëhet shiqimi i kontratës nr.333/0 të dt.12.12.l984, bëhet shiqimi në list.posed.nr.12, dhe nr. 8417 të dt.22.12.l996 bëhet shiqimi dhe leximi i kontratës me nr.11674/482 të dt.8.11.l963, bëhet leximi i aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.1058/94 i dt.07.12.l995, bëhet leximi i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.167/96 i dt.24.04.1996, bëhet leximi i vendimit të lëshuar nga Shërbimi Kadastral KK Prizren me nr.952-01-174/96 i dt.21.06.1996, bëhet shiqimi i skicave – aeroinçizimi i ngastrës kadastrale kontestuese, bëhet leximi i procesverbalit të dt.22.06.2010 mbi shiqimin e vendit si dhe leximi i raportit të ekspertit të angazhuar – atij gjeometër F. S., bëhet leximi i procesverbalit të lëshuar nga PPK.në Prizren me nr.952/01-174/06, bëhet leximi i procesverbalit të PPK-ës në Prizren me nr.446/07, po ashtu gjykata bëri vlerësimin e dëshmive të deponuara nga dëshmitarët e dëgjuar M. P., F. K. dhe N. Xh., kështu që me vlerësimin e gjithmbarshëm të të gjitha këtyre provave të administruara, veçmas secilën si dhe në lidhje me provat tjera dhe në kuptim të dispozitave ligjore të parapara me nenin 8 të LPK gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nga këto arsyera:

Me shiqimin e listës poseduese nr.12 të dt.05.11.1950 gjykata vërteton faktin se patundshmëria e evidentuar në këtë listë poseduese ka qenë e evidentuar në emër të ish pronarit të saj H. A. Me shiqimin e **kontratës mbi shitblerjen nr.11647/482 të dt.08.11.1963** vërtetohet fakti se me këtë kontratë të shitblerjes kontraktuesit pra ish pronari H. A. nga Prizreni si shitës dhe kontraktuesi – PIK "Progres" si blerës kanë hyrë në transaksion të shitblerjes të patundshmërisë parc.kad.nr.6856 list.posed.nr.1295 vendi i quajtur "B." e për sipërfaqen prej

1.23,90 ha. Në vazhdim me shiqimin dhe leximin e aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës komunale në Prizren **C.nr.1058/94 të dt.07.12.1995** vërtetohet fakti se me këtë aktgjykim është aprovuar kërkesëpadia e paditësve A. A. etj. dhe është anuluar kontrata mbi shitblerjen dhe është anuluar kontrata mbi shitblerjen Vr.nr.1850/63 e dt.08.11.1963 që ka qenë e lidhur në mes të H. A. tani të ndjerit dhe kontraktuesit PIK "Progres" kështu që patundshmëria e përfshirë me këtë aktgjykim – ngast.kad.nr.6856 me kulturë arë e klasit të III e në sipërfaqe prej 1.23,90 ha nga list.posed.nr.8417 ZK Prizren i kthehet bashkëpronarëve – paditësve H. A. etj. – fëmijëve të të ndjerit A. A. Po ashtu me shiqimin dhe leximin e **aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.167/96 të dt.24.04.1996** vërtetohet fakti se ankesa e të paditurit PIK "Progres" është refuzuar dhe **aktgjykimi i Gjykatës komunale në Prizren C.nr.1058/94 të dt.07.12.1995** është vërtetuar. Me shiqimin e vendimit të shërbimit kadastral në Prizren me nr.952-01-174/96 të dt.21.06.1996 vërtetohet fakti se në këtë shërbim kadastral e në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prizrenit atë C.nr.1058/94 bëhet ndryshimi në librat kadastrale dhe patundshmëria e përfshirë në këtë aktgjykim tani kalon të evidentohet në emër të paditësve – A. A. etj. Me shiqimin e list.posed.nr.4817-listës së re të dt.22.07.1996 vërtetohet fakti se patundshmëria me shënime – ara e klasit të III në vendin e quajtur "B." që evidentohet në ngast.kad.nr.6856 e në sipërfaqe prej l.23.90 ha evidentohet në emër të bashkëpronarëve A. e A1. A. dhe K. B. dhe M. S. me nga ¼ me shiqimin e kopjes së planit është skicuar në tërësi ngast.kad.nr. me shënimet nga shërbimi kadastral pra ngastra parc.kad.nr.6856. **Me leximin e raportit të shkruar dhe shiqimin e skicës së përpiluar nga eksperti gjeometër F. S., gjykata vërteton faktin siç sqaron eksperti se ngastra kad.nr.6856/1 vendi i quajtur "B." në sipërfaqe prej 0.77,90 ha evidentohet në listën poseduese tani me nr. të ri 11704 ZK Prizren në emër të bashkëpronarëve me nga ¼ dhe atë A. dhe A1. A., K. B. dhe M. S. Po ashtu i njëjti sqaron se në vend është bërë ky identifikim i kësaj ngastre ku është konstatuar se është sipërfaqe e lirë, pa objekte të ndërtuara dhe pa të mbjellura shumë vjeçare, e cila sipërfaqe është rrethuar me shtylla të betonit dhe tel rrethues.**

Me vlerësimin e të gjitha këtyre provave materiale gjykata konstaton për faktin se paditësit janë pronarë të ligjshëm të kësaj patundshmërie pra ngastrës kad.nr.6856/1 në vendin e quajtur "B." në sipërfaqe prej 0.77,90 ha që evidentohet në list.posed.nr.11704 ZK Prizren. Po ashtu konstatojmë se paditësit këtë bashkëpronësi e kanë fituar në mënyrë ligjore ashtu si është paraparë në dispozitat e nenit 36 të Ligjit për pronësinë dhe të drejta tjera sendore ligji nr.03/L-154, me të cilat dispozita ligjore në mënyrë taksative është paraparë **" për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri". Pra paditësit kanë përmbushur këto kushte ligjore për fitimin e pronësisë në këtë ngastër në fjalë, nga fakti se me aktgjykimin e plotfuqishëm atë C.nr.1058/94 të dt.07.12.1995 të marrur nga Gjykata Komunale e Prizrenit kanë fituar të drejtën e pronësisë në këtë patundshmëri, i cili aktgjykim përndryshe është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.1850/63 të dt.08.11.1963 dhe se në bazë të vërtetimit të shërbimit kadastral – vendimit 952-01-174/96 të dt.21.06.1996 kjo patundshmëri është bartur në librat kadastrale në emër të paditësve si bashkëpronarë. Po ashtu nga leximi i raportit të eksperti gjeometër të angazhuar është vërtetuar fakti se në**

terren është bërë copëtimi i kësaj sipërfaqe të përgjithshme asaj prej 1.23.90 ha të ngastrës 6856 dhe sipërfaqja prej 0.77.90 ha të ngastrës 6856/1 tani regjistrohet në emër të paditësve si bashkëpronarë, dhe se nga këto prova të lartpërmendura konstatojmë se është fjala për fitimin e të drejtës pronësore nga ana e paditësve në këtë patundshmëri që është e paditësve pra të njëjtit kanë "TË DREJTËN PRONËSORE PREFEKTE" dhe se nga kjo bazë ligjore të njëjtit kanë të drejtë të kërkojnë dhënien e kësaj patundshmërie në shfrytëzim dhe posedim të pa penguar, dhe se me dispozitat ligjore të parapara me nenin 93 të ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore është paraparë kjo mundësi nga se me këtë dispozitë është rregulluar me sa vijon " *pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar, prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi ".*

Pra nga këto arsyera dhe në kuptim të këtyre dispozitave ligjore gjykata konstaton se pronari mund të kërkojë nga mbajtësi kthimin e sendit individualisht të caktuar, dhe të paluajtshmërisë, por duhet të argumentojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon e ka të drejtën e pronësisë dhe sendi gjendet nën pushtetin faktik të padituri dhe se kjo e drejtë e pronarit nuk parashkruhet.

Në rastin konkret paditësi ka argumentuar të gjitha këto fakte se janë bashkëpronarë të kësaj ngastre kadastrale, kanë prova materiale për fitimin e pronësisë, mirëpo është i padituri – kundër paditësi që është në posedim të pa ligjshëm të kësaj patundshmërie dhe se paditësit me të drejtë kërkojnë dorëzimin e sendit që ndodhet në posedim të padituri duke parashtruar padi – "**padi reivindikacionit"** pra në rastin konkret këtë paluajtshmëri lëndore e mban i padituri – kundërpaditësi dhe se ai është mbajtës i pa ndërgjegjshëm, sepse ai e din se ai send i takon paditësit dhe se paditësi e kundërshton këtë mbajtje, pra nga këto arsyera dhe norma ligjore të lartshënuara është vendosur si nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ku i padituri – kundërpaditësi është obliguar që paditësve t'ua dorëzoj në posedim dhe shfrytëzim të lirë patundshmërinë me shënime si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Se në kthimin e pasurisë së tij, paditësit kanë të drejtë edhe sipas të drejtës Ndërkombëtare, e cila sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës neni 22 do të zbatohet në mënyrë direkte dhe ka epërsi të konfliktit mbi të gjitha dispozitat ligjore dhe aktet tjera të institucioneve publike. Me nenin 1 të protokollit të parë bashkë me Konventën Evropiane mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore është rregulluar në atë mënyrë që secili person juridik dhe fizik ka të drejtë në disponim të pa penguar të pasurisë së tij dhe askush nuk mund të jetë i privuar nga pasuria e tij, përveçse kur është në interes publik dhe në kushte të parapara me ligj dhe parime themelore të së drejtës ndërkombëtare.

Gjykata me vëmendje ka vlerësuar provat e administruara dhe atë shiqimin e vërtetimit me nr.423 të dt.22.12.2005 të lëshuar nga NJP "Dukagjini" Prizren, kontratat me nr.72, 29,55, 265, 19, 58 ku konstaton se me këto kontrata i padituri R. K. ka marrur me qesim patundshmërinë me shënime nga këto kontrata nga ish pronari KBI "Progres" dhe ka paguar anuitetet rreth shfrytëzimit të ujit kështu që janë këto prova jo kontestuese nga palët në procedurë. Po ashtu gjykata me vëmendje ka vlerësuar pohimet e dhëna nga dëshmitarët e dëgjuar M. P., F. K. dhe N. Xh., të cilët në dëshmitë e tyre pohojnë se është i padituri –

kundërpaditësi R. L. që e shfrytëzon pa ndërprerë më tepër se 30 vite këtë patundshmëri kontestuese të cilën siç pohon N. Xh. dhe i njëjti e ka blerë nga ish pronari kur persona të moshuar kanë arritur marrëveshje për këtë shitblerje gjersa është përmendur dhe çmimi për shumën prej 5000 Qese. Gjykata bëri vlerësimin e këtyre dëshmive dhe konstatoi se këto dëshmi vërtetojnë shfrytëzimin e kësaj patundshmërie nga ana e të padituri – kundërpaditësit R. K. Pra duke pasur parasysh këto prova të administruara pra kontratat për marrjen e kësaj ngastre në shfrytëzim nga i padituri kundërpaditësi R. K. me qesim nga KBI "Progres" nuk janë prova materiale të arsyeshme dhe ligjore për të fituar të drejtën e pronës ashtu si pretendon pala e paditur – kundërpaditësi – **pra shfrytëzimi me qesim** – apriori nuk mundëson fitimin e të drejtës në pronësi.

Gjykata në vazhdim konstaton për faktin se pala e paditur – kundërpaditësi gjatë shqyrtimeve të mbajtura edhe me kërkesën e gjykatës i njëjti nuk ka mundur të sigurojë provë materiale - kontratën mbi shitblerje në të cilën thirret se këtë patundshmëri e ka blerë nga ish pronari H. A. tani ndjeri, me arsyetim se kjo kontratë i është djegur në kohën kur janë djegur shtëpitë. Në këtë drejtim gjykata konstaton edhe për faktin se vetë i padituri – kundërpaditësi R. K. përmes të autorizuarit të tij av. H. K. gjykatës i ofron në shiqim provat materiale pra të gjitha këto kontrata të lidhur me PIK "Progresin" për shfrytëzimin me qesim të kësaj patundshmërie si dhe faturat për pagimin e qirasë dhe se **çuditërisht të njëjtit i mungon vetëm kontrata mbi shitblerjen kinse vetëm kjo i është djegur, dhe për gjykatën mbetet si çështje e pa besueshme, se vërtetë i padituri kundër paditësi ka pas kontratë të shkruar.**

Vërtetë i padituri kundërpaditësi R. K. kërkon mbrojtje ligjore nga gjykata me këtë kundërpadinë ku kërkesëpadia e mbështet në rrethanat se ai këtë patundshmëri e mban në shfrytëzim për kohë të gjatë që nga viti 1958, dhe se është kjo arsye ligjore se ka fituar të drejtën e pronësisë. Gjykata konstaton për faktin se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore ato të parapara me nenin 40 të ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore, me të cilat dispozita ligjore pra nenit 40 al.l në mënyrë taksative është paraparë " **personi i cili me mirëbesim e ka 20 vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në te. Në rastin konkret në anën e të padituri – kundër paditësit R. K. nuk janë plotësuar këto kushte ligjore nga se i padituri në fjalë këtë patundshmëri nuk e mban me mirëbesim meqë e din se është pronë e personit të tretë tani pronë e paditësve, e njëherit po ashtu është i vetëdijshëm se kjo patundshmëri gjerë në vitin l996 ka qenë pronë e PIK "Progresit" dhe me të njëjtën kanë lidhur kontratë për shfrytëzimin e kësaj patundshmërie kontratë me qesim, pra pasuria në fjalë gjerë në këtë kohë ka qenë e evidentuar në emër të pronës shoqërore. Duke pasur parasysh këto fakte pra edhe faktin se i padituri kundër paditësi R. K. thirret se i njëjti këtë patundshmëri e shfrytëzon që nga viti 1957 e në vazhdimësi edhe sot e kësaj dite ku pretendon në fitimin e të drejtës në bazë të parashkrimit, mirëpo gjykata në këtë drejtim sqaron për këto fakte. Vërtetë sipas dispozitave ligjore të ligjit mbi marrëdhëniet pronësore-juridike i cili ka qenë në fuqi në kohën kur i padituri ka qenë në shfrytëzim të kësaj patundshmëri – kësaj pronësie shoqërore që ka qenë në emër të PIK "Progresit" sipas nenit 29 të LMTHPJ "në pronën shoqërore nuk ka qenë e mundur të fitohet pronësia me parashkrim". Po ashtu konstatojmë për faktin se qysh me dt.03.08.1996 është bërë ndryshimi i kësaj dispozite ligjore pra është shlyer ky nen në fjalë mirëpo ligji nuk ka efekt retroaktiv sa i përket**

llogaritjes së afateve për fitimin e pronësisë nga prona shoqërore në bazë të parashkrimit dhe se afatet fillojnë për tu llogaritur nga dita e ndryshime të kësaj dispozite pra dt.03.08.1996 e këndej. Po ashtu konstatojmë se këto dispozita ligjore të ndryshuara me dt.03.08.1996, të LMTHPJ të njëjtat dispozita mund të zbatohen me këtë rast nga se janë në përputhje me nenin 1 dhe 2 të Urdhëresës së UNMIK-ut lidhur me aplikimin e ligjeve të cilat nuk janë diskriminuese, nëse kjo çështje nuk është rregulluar në mënyrë të veçantë. Pra nga kjo rregullativ ligjore gjykata është e mendimit se tani i padituri – kundërpaditësi ka pretendime të gabuara se i njëjti në bazë të parashkrimit mund të fitoj të drejtën e pronësisë në këtë ngastër kadastrale nga se nuk janë plotësuar kushtet ligjore ashtu si u konstatua më lartë pra mungon mirëbesimi dhe nuk kemi kalimin e afatit kohor të paraparë me ligj, janë këto arsyera ligjore në bazë të të cilave gjykata vendosi si nën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi kur refuzon kërkesëpadinë e palës së paditur – kundërpaditësit.

Nga të gjitha këto arsyera të lartpërmendura si dhe me aplikimin e dispozitave ligjore ato të parapara me nenin 93 dhe ato të parapara me nenin 40 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore të Rep. së Kosovës është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për masën e përkohshme në kuptim të dispozitave ligjore ato të parapara me nenin 309.2 të LPK.

Vendimi mbi shpenzimet është marrë në kuptim të nenit 452 të LPK, nga fakti se pala paditëse ka pasur këto shpenzime e të cilat janë llogaritur nga i autorizuari i saj në bazë të tarifës nr.7 dhe 8 të TA-së ku janë llogaritur shpenzimet për përpilimin e padis, 100 Euro, për parashtresat 50 Euro, taksa gjyqësore 35 Euro, shiqimi i vendit 100 Euro dhe 6 përfaqësime – 600 Euro gjithsejtë shumën prej 885 Euro.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.1005/09 të dt.29.05.2013

Sekretarja juridike **Gjyqtari**
Drita Gërmizaj **Naim Kurtishi**

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 15 ditësh nga dita e pranimit, dhe se ankesa i dorëzohet kësaj gjykate.